



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 18.12.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR SHQYRTIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 711, DATË 23.11.2018 “PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË TRE ANËTARËVE PËR KËSHILLIN MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, bazuar në nenin 44 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 18 dhjetor 2018, shqyrtoi Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 23.11.2018 “Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të tre anëtarëve për Këshillin Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë”.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm për t’iu përgjigjur pyetje të deputetëve Znj.Suela Popa, Znj.Edlira Luçi dhe Z.Ridvan Bode.

Komisioni, nga relacioni i cili shoqëronte Vendimin e Këshillit të Ministrave, konstatoi se procedura përzgjedhëse ishte bërë konform parashikimeve të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 44, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, sipas të cilës të drejtën e propozimit për tre nga këta anëtarë e ka Këshilli i Ministrave, mbështetur në performancën dhe gjykimin objektiv të përzgjedhjes së disa prej kandidatëve të përshtatshme për të kryer detyrën e anëtarit të këtij Këshilli. Gjithashtu, në relacionin që i bashkëlidhet vendimit shtjelloheshin çështjet përsa i takon shpalljes së procedurës së hapur nga Këshilli i Ministrave, për aplikim të çdo individi që plotëson kriteret e ligjit, dokumentacioni për t’u dorëzuar si dhe kriteret ligjore për kandidim dhe papajtueshmëria e funksionit. Nga relacioni rezulton se tre kandidatët janë përzgjedhur nga Këshilli i Ministrave në mes të 38 aplikantëve që ju përgjigjën thirrjes për aplikim.

Komisioni në seancën e datës 18 dhjetor ftoi të tre kandidatët duke kërkuar prej tyre jo vetëm një prezantim individual të meritave dhe aftësive të tyre profesionale, akademike të deritanishme, specifikisht në fushën e kërkuar nga ligji por, edhe vizionin e tyre lidhur me detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë.

Nga prezantimi i bërë si dhe referuar dokumentacionit që i bashkëlidhej Vendimit të Këshillit të Ministrave për nga secilin prej kandidatëve të propozuar, Komisioni vlerëson se kandidaturat

plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 44, pika 3 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe kriteret e papajtueshmërisë me funksionin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të parashikuara në nenin 46 të këtij ligji. Gjithashtu, nga Komisioni u konstatua se kandidaturat përmbushnin edhe kriteret ligjore të arsimimit profesional dhe akademik, si dhe të përvojës profesionale në sistemet bankare e financiare për këtë kandidim. Më konkretisht:

- Kandidatja **Suela Popa**: përmbush kriteret ligjore bazuar në kriterin e përvojës së punës dhe funksioneve që ka mbajtur në administratën publike, ku veçohet eksperiencia 6 vjeçare në funksione të ndryshme në Bankën e Shqipërisë si dhe një sërë kualifikimesh dhe trajnimesh të sektorit bankar, po ashtu dhe arsimimi juridik dhe ekonomik dhe çertifikimet në fushën financiare.
- Kandidatja **Edlira Luçi**: përmbush kriteret ligjore bazuar në kriterin e përvojës së punës, funksioneve të shumta në fushën financiare dhe anëtare e shumë bordeve dhe organizmave ekonomiko-financiare, me titull akademik “Doktor i Shkencave” në fushën e ekonomisë dhe “Profesor i Asociuar”, lektore dhe përgjegjëse në Universitetin e Tiranës, Departamenti i Financës.
- Kandidati **Ridvan Bode**: përmbush kriteret ligjore bazuar në kriterin e përvojës së punës, funksioneve të larta në kabinetet qeveritare duke mbajtur pozicionin e Ministrit të Financave për 9 vite në periudha të ndryshme qeverisëse, deputet në 5 Legjislatura dhe mbajtës i gradës Doktor i Shkencave Ekonomike.

Për këto arsye, Komisioni e miratoi, me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm në mbledhje, propozimin e Këshillit të Ministrave për tre anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe ia paraqet seancës plenare për votim.

KRYETARI

Erjon BRAÇE